



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 10, datë 14.04.2017

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINA E RE E MJEKËSISË SË PËRGJITHSHME 6 KATE MBITOKË DHE 2 KATE NËNTOKË”, BRENDA KORPUSIT TË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE TË TIRANËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godina e re e Mjekësisë së Përgjithshme 6 kate mbitokë dhe 2 kate nëntokë”, brenda korpusit të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës, me zhvillues Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OGERTA MANASTIRLIU



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

